



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 maj 2021
Nr. ref.: RK 1791/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI120/20

Parashtrues

N.T.SH. "Virtuo"

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit, E. Rev.nr. 23/2020, të 27 prillit 2020,
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania N.T.SH. Virtuo me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson avokati Albert Islami nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. nr. 23/2020] e 27 prillit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale), të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 28 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
6. Më 3 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi (anëtarë).
7. Më 17 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 gusht 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
9. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 prill 2012, parashtruesi i kërkesës dhe kompania "Printec" L.L.C, kishin nënshkruar marrëveshje të përbashkët të ndërmarrësisë me ç' rast të dyja palët kishin këmbyer informata për bizneset e tyre. Sipërmarrja e përbashkët ishte emëruar si "*Printec L.L.C & N.T.SH Virtuo*". Qëllimi themelor i bashkëpunimit

ishite përgatitja e ofertës dhe pjesëmarrja në tender të shpallur nga Lux Development, në emër të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: MSH). Palët ishin pajtuar që lider i sipërmarrësisë ishte "Printec" L.L.C, ndërsa anëtare ishte parashtruesi i kërkesës, përkatësisht N.T.SH "Virtuo". Kontratën e kishin nënshkruar Y. Sh, në emër të "Printec" L.L.C dhe Glauk Hoxha, në emër të N.T.SH "Virtuo", e cila dëshmohej nga marrëveshja e përbashkët e ndërmarrësisë e 18 prillit 2012.

11. Më 18 prill 2012 dhe 20 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës N.T.SH "Virtuo" dhe "Printec" L.L.C e kishin autorizuar me shkrim Y.Sh. që të ndërmernte të gjitha aktivitetet në emër të sipërmarrjes duke përfshirë përgatitjen e dokumenteve, dorëzimin e ofertës dhe ekzekutimin e kontratës. Rrjedhimisht, i autorizuari Y.Sh., kishte përgatitur dokumentacionin dhe kishte paraqitur ofertën në emër të sipërmarrjes "Printec L.L.C & N.T.SH Virtuo" e cila pastaj ishte shpallur fituese e tenderit.
12. Më 10 mars 2014, është lidhur kontrata e furnizimit [KSV/014. 12. 051] në mes të MSH-së si autoritet kontraktues, dhe sipërmarrjes "Printec L.L.C & N.T.SH Virtuo", si operator ekonomik. Në emër të sipërmarrjes apo grupimit siç quhej në tender, kontratën e kishin nënshkruar i autorizuar i këtij grupimi Y.Sh. Palët e kishin pranuar përfaqësimin si të rregullt dhe kishin filluar me përmbushjen e zotimeve të marra me kontratë. Po ashtu, gjykatat e rregullta kishin gjetur se në kohën e lidhjes së kontratës, Y.Sh. ishte menaxher i përgjithshëm i "Printec" L.L.C, ndërsa me 18 korrik 2014, ishte emëruar drejtor i dytë menaxhues, në mbledhjen e aksionarëve të palës "Printec" L.L.C. Në të njëjtën datë, aksionarët e "Printec" L.L.C në mënyrë unanime dhe të pakushtëzuar i kishin konfirmuar dhe pranuar të gjitha transaksionet e kryera nga Y.Sh., në emër "Printec" L.L.C duke përfshirë edhe kontratën me MSH-në. Po ashtu, nga procesverbali i mbledhjes së aksionareve të "Printec" L.L.C, të 18 korrikut 2014, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se aksionarët e kësaj shoqërie tregtare kanë konfirmuar se Y.Sh. në lidhjen e kontratës së lartpërmendur ka vepruar si person i autorizuar.
13. Më 11 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër të paditurit "Printec" L.L.C, për anulim të pjesshëm të kontratës dhe shpërblim të dëmit. Parashtruesi i kërkesës kërkonte anulimin e kontratës së lartcekur dhe atë vetëm për palën e paditur, me pretendimin se nënshkruesi i kontratës Y.Sh, nuk ishte Drejtor i Përgjithshëm i palës së paditur dhe se i njëjti nuk ka pasur autorizim për nënshkrimin e kontratës. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Y.Sh. për shkak të paraqitjes së tij në mënyrë jo legjitime dhe të paautorizuar, është sjellë me keqbesim dhe në mënyrë të pandërgjegjshme, duke i shkaktuar kështu parashtruesit të kërkesës një dëm real prej 30,000.00 € dhe fitim të humbur prej 830,000.00 €.
14. Në anën tjetër, pala e paditur "Printec" L.L.C, kontestoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke mbajtur qëndrimin që Y.Sh., ka qenë menaxher i përgjithshëm i të paditurit dhe se i njëjti ishte i autorizuar nga të dy palët që të nënshkruaj kontratën me MSH-në.
15. Më 10 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit

[I.C.nr.435/2014]: (I) Refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër të paditurit "Printec" L.L.C, me të cilën kishte kërkuar që:- Të anulohet kontrata për furnizim [KSV/O 14.12 051], e lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit, me MSH-në, projekt i Qeverisë së Holandës dhe Luksemburgut- në pjesën që i referohet të paditurit "Printec" L.L.C;.- Për parashtruesin e kërkesës, kontrata e lartcekur të mbetet në fuqi; - Të detyrohet i padituri "Printec" L.L.C, që në emër të dëmit material, t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 30,000.00 €, ndërsa në emër të fitimit të munguar t'ia paguaj shumën prej 830,000.00 €; (II) Detyrohet parashtruesi i kërkesës, që të paditurit t'ia paguaj shumën prej 2,215.20 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

16. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor kishte paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, ta prishë Aktgjykimin [I.C.nr.435/2014] e Gjykatës Themelore, ose ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rigjykim.
17. Në një datë të pacaktuar, pala e paditur "Printec" L.L.C parashtroi përgjigje në ankesë duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta refuzoj ankesën e palës paditëse si të pabazuar dhe të vërtetojë Aktgjykimin [I.C.nr.435/2014] e 10 marsit 2017, të Gjykatës Themelore.
18. Më 6 nëntor 2019, Gjykata e Apelit, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) përmes Aktgjykimit [Ae.nr. 103/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [I.C.nr.435/2014] e 10 marsit 2017, të Gjykatës Themelore.
19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni dhe të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura të Gjykatës Themelore dhe të Apelit, si dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar.
20. Në një datë të pacaktuar, "Printec" L.L.C në përgjigje të revizionit kontestoi në tërësi pretendimet e revizionit të parashtruesit të kërkesës dhe propozoi që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.
21. Më 27 prill 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.23/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“përmes aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, atij i janë cenuar dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke cenuar substancialisht garancitë kushtetuese të inkuorporuara në korpusin e kësaj dispozite kushtetuese për një gjykim korrekt, të paanshëm, të drejtë, të rregullt dhe fer.”* Rrjedhimisht, *“Aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk janë në pajtim me dispozitat e cituara kushtetuese dhe se Aktgjykimi i kontestuar është në kundërtënie substanciale me faktet dhe provat juridikisht të vlefshme që janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, gjë kjo e cila ka kushtëzuar në tërësinë e tij një proces të parregullt, të padrejtë dhe të njëanshëm.”*
24. Sipas parashtruesit të kërkesës, *“konstatimi i Gjykatës Supreme se Y.Sh. ka pasur legjitimitet dhe autorizime të nevojshme për të ndërmarrë veprimet si i autorizuar i palëve në kontest, në kuadër të tenderit dhe ekzekutimit të kontratës, është konkludim arbitrar, selektiv, i njëanshëm i cili jo vetëm që nuk gjen mbështetje në provat e administruara dhe faktet e vërtetuara por është sajësë e formulimeve stereotipe me parafrazime boshe, të cingura, arbitrare, të ngatërruara dhe tronditëse, për të krijuar amulli për parashtruesin e kërkesës”* dhe rrjedhimisht atij *“i është shkelur garancia kushtetuese për një aktgjykim të paanshëm dhe të drejtë”*.
25. Sipas parashtruesit të kërkesës Y.Sh. kur ka nënshkruar kontratën e furnizimit në cilësinë e *“general manager”*, ndonëse nuk ka qenë i autorizuar as me statutin e shoqërisë tregtare *“Printec” L.L.C* e as me marrëveshjen për ndërmarrjen e përbashkët (joint venture), e as me autorizimin e së njëjtës të datës 18 prill 2012.
26. Parashtruesi në vijim pretendon që Y.Sh. bazuar nga vërtetimi i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (në tekstin në vijim: ARBK) nr. 554 të 15 qershorit 2014, konfirmohet se asnjëherë nuk ka qenë i emëruar me statutin e të paditurit *“Printec” L.L.C* dhe as që është regjistruar në cilësinë e të ashtuquajturit *“drejtor gjeneral”* (general manager). Rrjedhimisht, konstatimi se Y.Sh. kishte legjitimitet dhe autorizim për ndërmarrje të veprimeve është marrë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 110 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare (në tekstin në vijim: LSHT), pasi që Kuvendi i aksionarëve i të paditurës *“Printec” L.L.C* asnjëherë nuk e ka emëruar me statut Y.Sh. në cilësinë e drejtorit gjeneral dhe se, i njëjti nuk është regjistruar në cilësi të tillë. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, përderisa kontrata e furnizimit është nënshkruar nga Y.Sh. i cili qartazi nuk ka qenë as i caktuar e as i regjistruar në ARBK sipas dispozitës së nenit 109 (Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve menaxhues) dhe 110 (Autorizimi i drejtorit menaxhues për të vepruar në emër të shoqërisë) të LSHT-së, ndaj edhe kontratat e nënshkruara janë absolutisht *nule* dhe nuk prodhojnë efekt juridik që nga fillimi (*ex tunc*) dhe si të tilla duhet detyrimisht të shpallen të pavlefshme.
27. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës thekson se përderisa ndërmarrja e përbashkët (joint venture) sipas marrëveshjes së 12 prillit 2012, duke mos qenë e regjistruar në ARBK, të njëjtës i mungon elementi konstitutiv i regjistrimit të parashikuar me dispozitat përkatëse të LSHT-së. Prandaj, kjo marrëveshje nuk prodhon efekt juridik dhe nuk gëzon mbrojtje gjyqësore.

28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se konstatimi i Gjykatës Supreme se *“veprimet e kryer nga Y.Sh. janë konfirmuar dhe pranuar nga i padituri "Printec" L.L.C. në mbledhjen e aksionarëve të dt. 18.07.2014 me ç’rast, Y.Sh. është emëruar drejtor i dytë menaxhues”* bie ndesh me dispozitën e nenit 33 dhe 109 paragrafi 1 të LSHT-së. Kjo ngase Y.Sh. nuk është emëruar me statutin e të paditurës dhe i njëjti nuk është regjistruar në ARBK në cilësinë e tillë. Prandaj, caktimi me statut dhe regjistrimi në cilësinë e drejtorit menaxhues është kusht esencial (*conditio sine qua non*) për të vepruar në emër dhe për llogarinë e të paditurës.
29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur garancia kushtetueses sipas dispozitës së nenit 24 të Kushtetutës. Sipas tij, përmes aktgjykimit të kontestuar, atij nuk i është garantuar mbrojtja e barabartë gjyqësore para ligjit, pasi që Gjykata Supreme duke zbatuar gabimisht të drejtën materiale të konkretizuar përmes paragrafit 2 të nenit 72 (Mundësia e Përfaqësimit) të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin në vijim: LMD) mbi bazën e selektimit negativ në dëm të parashtruesit të kërkesës *“ka krijuar pabarazi, padrejtësi, arbitrarizëm, njëanshmëri dhe rrjedhimisht, diskriminim.”* Pra, sipas parashtruesit *“Gjykata Supreme në mënyrë selektive aplikon dispozitën e nenit 72, paragrafi 1 të LMD-së që nuk i referohet shoqërive tregtare apo personave juridike, por ka të bëjë me persona fizikë. Ndërkaq, qëllimisht nuk e aplikon dispozitën e nenit 72, paragrafi 2 të LMD-së, dispozitë kjo që i referohet shoqërive tregtare siç është rasti konkret.”*
30. Parashtruesi i kërkesës tutje në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës thekson se *“Gjykata Supreme ka bërë vlerësimin selektiv të provave dhe në tërësinë e tyre nuk ka marrë aktgjykim të drejtë, të rregullt dhe të paanshëm. Madje, duke mos bërë vlerësimin e të gjitha provave të palëve ndërgjyqëse (barazia e armëve) nuk ka dhënë arsyet se pse i quan të paprovuara provat e paraqitura nga paditësi – parashtruesi i kërkesës.”*
31. Përfundimisht parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) ta shpallë kërkesën e Parashtruesit të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24 (barazia para ligjit) dhe 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ (e drejta për një proces të rregullt);
32. Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 23/2020] të 27 prillit 2020; (iii) ta urdhërojë Gjykatën Supreme të Kosovës që, duke anuluar Aktgjykimin e saj [E. Rev. nr. 23/2020] dhe të Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 103/2017] të 6 nëntorit 2019, ashtu që Gjykata e Apelit të vendos në riprocedurë lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike në Prishtinë [I.c.nr. 435/14] i 10 marsit 2017.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Ligji Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore

Neni 321

321.4 Faktet, ekzistimin e të cilave e presupozon ligji, nuk duhet provuar, por mund të provohet mosekzistimi i tyre, po që se me ligj nuk është përcaktuar diç tjetër.

[...]

Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare

Neni 33

Regjistrimi dhe Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

33.1 Për regjistrimin dhe themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, themeluesi duhet të nënshkruajë dhe të dorëzojë në Zyrën e Regjistrimit statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, i cili duhet të përmbajë këto informata:

a) emrin zyrtar të shoqërisë, në fund të të cilit duhet të përfshihet shkurtesa "SHPK" ose ekuivalenta në njërin nga gjuhët e përcaktuara në paragrafin 5 të nenit 13 të këtij ligji;

b) adresa në Kosovë në të cilën shoqëria ushtron veprimtarinë e saj kryesore tregtare;

c) adresa e zyrës së regjistruar (selisë) të shoqërisë dhe emri i agjentit të saj të regjistruar në këtë adresë,

d) qëllimi afarist i shoqërisë, i cili mund të përshkruhet si "qëllim i ligjshëm afarist";

e) emri dhe adresa e secilit themelues të shoqërisë; nëse një themelues është person fizik, atëherë duhet të sigurohet emri i plotë i tij dhe adresa e vendbanimit të përhershëm, që mund të jetë brenda ose jashtë Kosovës; nëse një themelues është shoqëri tregtare e Kosovës, emrin dhe adresën e zyrës së regjistruar në Kosovë; nëse themeluesi është shoqëri e huaj tregtare, emrin dhe adresën zyrtare të vendit kryesor ku ushtrohet veprimtaria e saj jashtë Kosovës;

f) numri i personave që do të shërbejnë si drejtorë të kompanisë si dhe emri dhe adresa e të gjithë personave që do të shërbejnë si drejtorë fillestarë të kompanisë. Nëse një drejtor është me vendbanim në Kosovë, atëherë duhet të sigurohet adresa e vendbanimit të tij në Kosovë; nëse një drejtor nuk është me vendbanim në Kosovë, atëherë duhet të sigurohet adresa e vendbanimit të tij/saj jashtë Kosovës;

g) data e fundit, nëse ajo ekziston, në të cilën shoqëria do të shpërbëhet;

h) shuma e kapitalit themeltar të shoqërisë, i cili duhet të jetë më së paku 1.000 Euro;

i) shuma e kapitalit themeltar të shoqërisë e cila është paguar në kohën e regjistrimit të shoqërisë;

j) shuma (nëse ka të tillë) e kapitalit themeltar të shoqërisë i cili është zotuar por që nuk është paguar në kohën e regjistrimit të shoqërisë;

k) emrat dhe adresat e pronarëve dhe interesave të tyre përkatëse pronësore; dhe

l) një deklaratë me të cilën vërtetohet se personi i cili e nënshkruan dhe dorëzon këtë statut është “person i autorizuar” në kuptim të këtij ligji, dhe se i njëjti është i autorizuar për nënshkrimin dhe dorëzimin e statutit në Zyrën e Regjistrimit.

33.2 Personi i cili nënshkruan dhe dorëzon statutin, duhet ti bashkangjesë atij edhe pëlqimin me shkrim të agjentit të regjistruar për të shërbyer në këtë cilësi. Ky pëlqim me shkrim duhet të nënshkruhet nga agjenti i regjistruar. Nëse agjenti i regjistruar është shoqëri tregtare, statuti duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar i saj.

33.3 Personi i cili e ka nënshkruar dhe dorëzuar statutin duhet gjithashtu t’ia bashkangjesë edhe një kopje të marrëveshjes së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas nenit 86 të këtij ligji, të nënshkruar nga të gjithë pronarët e përcaktuar në statutin burimor. Sidoqoftë, është me rëndësi të veçantë që (i) kërkesat e parapara në këtë nen të shërbejnë vetëm për qëllime të informimit publik, (ii) Zyra e Regjistrimit nuk është i autorizuar që t’i shqyrtojë mangësitë ligjore ose formale të marrëveshjes së shoqërisë, dhe (iii) Zyra e Regjistrimit nuk është i autorizuar ta refuzojë regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për shkak të formës, përmbajtjes ose kushteve të përcaktuara në rregullore, dhe (iv) regjistrimi i marrëveshjes së shoqërisë nuk do të thotë dhe nuk nënkupton se marrëveshja, ose cilado dispozitë e saj, janë në pajtim me statutin ose kërkesat e këtij ligji.

Neni 109

Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve menaxhues

109.1 Pronarët e shoqërisë do të përcaktojnë në statut, ose në një ndryshim dhe plotësim të statutit ose marrëveshjes së shoqërisë, personin ose personat e caktuar për të shërbyer si drejtorë menaxhues. Personi/at në fjalë kanë kompetencat e përcaktuara në nenin 110 të këtij ligji. Kur ka më shumë se një drejtor menaxhues, marrëveshja e shoqërisë mund të përcaktojë tituj, detyra dhe autorizime të ndryshme për secilin prej tyre. Një drejtor menaxhues mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës sëpronarëve. Një drejtor menaxhues nuk ka nevojë të jetë pronar. Një drejtor menaxhues duhet të jenëperson fizik.

109.2 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, drejtori i zgjedhur menaxhues vazhdon të mbetet në këtë detyrë përderisa të shkarkohet ose zëvendësohet me votën e pronarëve, ose derisa të japë dorëheqje, cilado që ndodh më herët.

109.3 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, drejtori menaxhues shkarkohet me votën e pronarëve. Pronarët nuk kanë nevojë të deklarojnë arsyen për shkarkimin e tij, dhe personi i shkarkuar nuk ka të drejtë të kërkojë nga pronarët arsyen për shkarkimin e tij/saj.

Neni 110
Autorizimi i drejtorit menaxhues për të vepruar në emër të shoqërisë

110.1 Varësisht nga ndonjë dispozitë në të kundërtën në këtë ligj ose në marrëveshjen e shoqërisë, drejtori menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësojë shoqërinë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare, duke përfshirë edhe autorizimin (i) për udhëheqjen e veprimtarisë së zakonshme të shoqërisë, dhe (ii) për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në emër të shoqërisë nëse ky nënshkrim ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e veprimtarisë së zakonshme tregtare të shoqërisë. Këto veprime të drejtorëve menaxhues e detyrojnë shoqërinë, përveç nëse (i) veprimi është jashtë autorizimit të drejtorit menaxhues sipas marrëveshjes së shoqërisë dhe (ii) personi ose shoqëria me të cilit drejtori menaxhues ka punuar e ka ditur se drejtorit menaxhues i mungon autorizimi për të vepruar në emër të shoqërisë.

110.2 Një veprim i drejtorit menaxhues i cili nuk është në vazhden e ushtrimit të veprimtarisë së rregullt tregtare të shoqërisë, është i detyrueshëm për shoqërinë vetëm nëse ky veprim është autorizuar shprehimisht (i) nga marrëveshja e shoqërisë, ose (ii) me një autorizim të posaçëm të miratuar me votën e pronarëve.

110.3 Cilido person, përfshirë drejtorin menaxhues, i cili me dijeni shtiret se vepron në emër të shoqërisë pa autorizimin e nevojshëm, është personalisht përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar shoqërisë apo personit ose organizatës tjetër nga këto veprime.

110.4 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, secili drejtor menaxhues i shoqërisë e cila ka dy ose më shumë drejtorë menaxhues do të ketë autorizimin dhe të drejta të njëjta për menaxhimin e shoqërisë.

Ligji Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet E Detyrimeve

Neni 72
Mundësia e përfaqësimit

1. Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues.

2. Autorizimi për përfaqësim bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në deklarinë e vullnetit të të përfaqësuarit (prokura).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 113

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

36. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtguesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtgues *“Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtguesi i kërkesës Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Aktvendimi për Papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev.nr. 23/2020] të 27 prillit 2020, të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç këtyre kushteve, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkesave kushtetuese, të përcaktuara në nenin 39 të Rregullores së punës të Gjykatës. Në këtë drejtim, Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

39. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe

të paqarta”. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).

41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, për (i) anulimin e pjesshëm të kontratës së furnizimit [KSV/014. 12. 051] në mes të MSH-së si autoritet kontraktues dhe sipërmarrjes së përbashkët "*Printec L.L.C & N.T.SH Virtuo*", si operator ekonomik, vetëm për palën e paditur "*Printec*" L.L.C, me pretendimin se nënshkruesi i kontratës Y.Sh, nuk ishte Drejtor i Përgjithshëm i palës së paditur dhe se i njëjti nuk ka pasur autorizim për nënshkrimin e kontratës; dhe (ii) kërkesës për kompensim të dëmit, për shkak të paraqitjes jo legjitime dhe të paautorizuar të Y.Sh. me ç' rast parashtruesi pretendon se i është shkaktuar një dëm material prej 30,000.00 € dhe fitim i humbur prej 830,000.00 €. Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër të paditurit "*Printec*" L.L.C. Duke vepruar sipas ankesës përkatëse dhe kërkesës për revizion, Gjykata e Apelit, e të cilën e konfirmon edhe Gjykata Supreme kishin refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës, i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, përkatësisht neneve 33, 109 dhe 110 të LSHT-së; (ii) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, përkatësisht paragrafit 1 të nenit 72 të LMD-së. Në vijim Gjykata do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
43. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm, përbëjnë kategori pretendimesh, të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, në parim, i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
44. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 275 dhe 304), parimin e

subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

45. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
46. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës. (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e "*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*", shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil) të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
47. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërlidhen me nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, në kundërshtim me nenet 33, 109 dhe 110 të LSHT-

së, dhe pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës ndërlidhen me aplikimin e gabuar të nenit 72 paragrafi 1 i LMD-së.

48. Përkitazi me këto pretendime, përkatësisht nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar në kundërshtim me dispozitat e LSHT-së dhe LMD-së, Gjykata fillimisht thekson se të njëjtat nuk qartësojnë saktësisht dhe nuk paraqesin në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Megjithatë, Gjykata vëren se pretendime të tilla, janë trajtuar nga gjykatat e rregullta.

49. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.C.nr.435/2014] të 10 marsit 2017, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

“[...] Me nenin 72 paragrafi 1 të LMD-së është e përcaktuar se kontrata mund të lidhet me anë të përfaqësuesit. Në rastin konkret paditësi ka pretenduar se personi i cili e ka lidhur kontratën me Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka pasur autorizim për lidhjen e kontratës nga pala e paditur. Ndërsa gjykata ka konstatuar se z. Y.Sh. ka qenë i autorizuar nga grupi "Printec LLC & Virtuo NTSH" për të ndërmarrë veprimet lidhur me tenderin e shpallur. Për më tepër, në mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionareve të palës së paditur, në mënyrë unanime, është konfirmuar se të gjitha transaksionet e ndërmarra nga z.Y.Sh., duke përfshirë edhe lidhjen e kontratës me Ministrinë e Shëndetësisë, kanë qenë të autorizuar dhe janë të pranueshme. Kështu që pretendimi i paditësit për anulimin e kontratës vetëm për të paditurin për shkak të mungesës së autorizimit për z. Y.Sh. për lidhjen e kontratës, është i pa bazuar, dhe si të tillë gjykata e ka refuzuar. “

50. Në anën tjetër, edhe Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.103/2017] të 6 nëntorit 2019, kishte trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar, ndër të tjera, si në vijim:

“Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht dispozitën e nenit 72 paragrafi 1 të LMD-së, i cili parasheh se: "Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues". Në rastin konkret personi i cili e ka nënshkruar kontratën ka qenë i autorizuar ta nënshkruaj kontratën, dhe kjo vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës respektivisht nga autorizimet e datës 18.04.2012 dhe 20.11.2012 si dhe nga procesverbali i datës 18 korrik 2014, nga i cili konfirmohen veprimet e z. Y.Sh., si person ka qenë i autorizuar për të ndërmarrë veprimet lidhur me kontratën kontestuese. Prandaj pretendimi i paditësit për anulimin e kontratës vetëm për të paditurin për shkak të mungesës së autorizimit për z. Y. Sh., për lidhjen e kontratës, është i pa bazuar. Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me mos marrjen e provave me dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe nxjerrjen e ekspertizës në lëmin e IT -së, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar këto pretendime të palës paditëse, për arsye se veprimet e z. Y.Sh. kanë qenë të autorizuar.”

51. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton se Gjykata e Supreme, përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr. 23/2020] të 27 prillit 2020, kishte trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar, ndër të tjera, si në vijim:

“Në revizionin e paditësit thuhet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë përfshihet me shkelle thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2. pika n të LPK, kjo ngase këto gjykata, në këto aktgjykime nuk kanë dhënë shpjegime dhe sqarime të qarta dhe të plota për faktet vendimtare se pse i quajnë të vërtetuara ato fakte, duke mos bërë vlerësimin e provave kontradiktore, të propozuara dhe të administruara nga vetë gjykata. Këto pretendime të revizionit Gjykata Supreme i refuzoi si të pabazuara ngase të dy gjykatat e lartpërmendura lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë kanë dhënë sqarime të plota dhe të qarta për faktet vendimtare nga të cilat është varur zbatimi i drejt i së drejtës materiale, e që kanë të bëjnë me faktin vendimtar, se z. Y.Sh., ka pasur legjitimitetin dhe autorizimet e nevojshme për të ndërmarr veprimet si i autorizuar i palëve në kontest, në kuadër të tenderit dhe ekzekutimit të kontratës së lartpërmendur për të cilën arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për ekspertiza gjyqësore dhe dëgjim të dëshmitarëve lidhur me këtë rrethanë, kjo ngase veprimet e të autorizuarit z. Y.Sh., edhe më vonë janë konfirmuar dhe pranuar nga i padituri. Nga kjo rezulton se asnjëri prej këtyre aktgjykimeve nuk përfshihet me të meta dhe paqartësi në arsyetimin e tyre përkitazi me faktet vendimtare nga të cilat varet zbatimi i drejt i së drejtës materiale, dhe në këtë drejtim pretendimet e revizionit vlerësohen si të pabazuara.”

52. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me interpretimin e gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm. Të njëjtat, kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe kishin sqaruar se Y.Sh. në bazë të provave të administruara ishte i legjitimuar për të përfaqësuar sipërmarrjen e përbashkët "Printec LLC & Virtuo NTSH".
53. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
54. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë "aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar", duke rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e "shkallës së katërt" dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të "ligjshmërisë" dhe nuk janë argumentuar në

nivel të "kushtetutshmërisë". Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

55. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm në rrethanat e rastit të tij, përbëjnë pretendime të "shkallës së katërt" dhe si të tilla, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
56. Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi